



Gjakovë-Djakovica-Gjakova

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Datë: 13.01.2023

Komuna e Gjakovës përkatësisht Drejtoria e Shërbimeve Publike, duke u bazuar në nenin 6, të LIGJI Nr. 06/L -079 Për Eficiencë të Energjisë dhe me qëllim të zbatimit të vendimit të Qeverisë së Kosovës Nr. 28/96 i datës: 14.09.2022, shpallë këtë:

FTESË PËR APLIKIM

PER HARTIMIN E PLANIT TE VEPRIMIT KOMUNAL PER ENERGJI DHE KLIM (PVKEK)

Komuna e Gjakovës i fton të gjitha OJQ-ët që janë të interesuar të kryejnë shërbimin e Hartimit të Planit të Veprimit Komunal Per Energji Dhe Klim (PVKEK), që të aplikojnë për kryerjen e këtij shërbimi.

Hyrje

Me hartimin e planit të veprimit për energji dhe klimë, (PVKEK), Komuna e Gjakovës synon arritjen e objektivave për kursim të energjisë përmes donatoreve dhe mekanizmave tjerë financiar si dhe anëtarësimin e Komunës në Konventën të Kryetarëve (KK).

Në fund vitit 2008, Komisioni Evropian ka iniciuar ndërlidhjen e kryetarëve të qyteteve (krye bashkiakeve) të qyteteve evropiane për energji dhe klimë në një rrjet të përhershëm me qëllim që të shkëmbejnë përvojat në zbatimin e masave efektive për përmirësimin e efikasitetit të energjisë dhe klime në mjedis urban.

Përmes kësaj thirrje Komuna e Gjakovës do të jetë zbatuese edhe Vendimit të Qeverisë Nr.28/96 të datës 14.09.2022 për të planifikuar masat e kursimit të energjisë në ndriçim publik.

Iniciativa e Konventës të Kryetareve (KK) është përgjigje e qytetarëve, udhëheqësve evropian ndaj sfidave të ndryshimit të klimës globale dhe në të njëjtën kohë, ajo është nisma më ambicioze e Komisionit Evropian, drejtpërdrejt e orientuar drejt përfshirjes aktive dhe pjesëmarrjes të vazhdueshme të administratës Komunale dhe vetë qytetarëve në luftën kundër ngrohjes globale.

Me nënshkrimin e Konventës, kryetarët e komunave do të angazhohen për zbatimin e masave të shumta të efikasitetit të energjisë dhe klimës, të cilat në fund do të çojnë në zvogëlimin e emisioneve të CO₂, në qytete të tyre më me shumë se 20% gjatë vitin 2030, siç kërkohej me Propozimin e Politikës Evropiane për Energji dhe Klimë nga viti 2017.

Roli i administratës komunale manifestohet nëpërmjet përgjigjeve vijuese të përcaktuara nga Konventat e Kryetareve (KK):

- Zbatimi i masave, projekteve dhe programeve të efikasitetit të energjisë dhe klimës në ndërtesat publike, në pronësi ose me qira nga komuna;
- Zbatimi i masave, projekteve dhe programeve të efikasitetit të energjisë dhe klimës dhe ruajtjen e mjedisit në sektorin e transportit publik të Komunës;
- Zbatimi i masave, projekteve dhe programeve të efikasitetit të energjisë dhe klimës në sektorin e ndriçimit publik të komunës;
- Planifikimi i zhvillimit të qytetit bazuar në energjinë dhe klimën e qëndrueshme;
- Zbatimi i aktiviteteve të vazhdueshme lidhur me mënyrat e rritjes së efikasitetit të energjisë dhe zvogëlimin e emisioneve të CO₂, me qëllim të ngritjes së vetëdijes së qytetarëve për nevojën e kursimit të energjisë dhe klimës në të gjitha fushat e jetës dhe punës;
- Mbështetja e programeve dhe nismave të personave të ndryshëm fizik dhe juridik me qëllim të rritjes së përdorimit të burimeve të ripërtërishme të energjisë;
- Promovimi i prodhimit vendor të energjisë nga burimet e ripërtërishme dhe ko-gjenerimi.

AKTIVITET:

Analiza e konsumit të energjisë sipas sektorëve:

- Konsumi i energjisë në ndërtesat publike
- Konsumi i energjisë në ndërtesat administrative
- Konsumi i energjisë në ndërtesat e nënsektorit të arsimit shkencës dhe teknologjisë
- Konsumi i energjisë në ndërtesat e nën sektorit të shëndetësisë
- Konsumi i energjisë në ndërtesat e nën sektorit kulturë dhe sport
- Konsumi i energjisë në sektorin e ndriçimit publik
- Konsumi i energjisë në ndërtesat e Banimit
- Konsumi i energjisë sektorin afarist.

Vërejtje:

Sektori i ndriçimit do të analizohet në mënyrë detale jo vetëm konsumi i energjisë por edhe gjendja ekzistuese dhe planifikimi i zgjerimit të ndriçimit publik.

Nga gjendja ekzistuese kërkohet sasia e trupave ndriçues, lloje të tyre LED, Na, Hg apo CFL kapaciteti instalues në W i të gjitha trupave ndriçues.

Identifikimi i shtyllave të ndriçimit – Metalike: lartësia/distanca, lokacioni, Betonit - lartësia/distanca dhe Drurit - lartësia/distanca.

Gjendja ekzistuese e kabinave elektrike (ormanëve), njësoret-orat matëse, sistemi i kabllimit dhe faturat nga KEDS për vitin 2021 dhe 2022.

Përmbledhja e këtij aneksi do të vendoset në PVKEK 2023-2030 si shtojcë.

Analiza e konsumit të energjisë në bujqësi dhe transport;

- Konsumi i energjisë në sektorin e bujqësisë
- Konsumi i energjisë në transportin publik të udhëtarëve
- Konsumi i energjisë në transportin privat të udhëtarëve dhe mallrave
- Konsumi i energjisë në transportin e Flotës Komunale
- Konsumi i energjisë në transportin Taxi

Analiza e potencialit të efijencës së energjisë sipas sektorëve;

- Sektori i shërbimeve – ndërtesat publike
- Ndërtesat e administratës
- Ndërtesat e nën sektorit të arsimit shkencës dhe teknologjisë
- Ndërtesat e nën sektorit të shëndetësisë
- Kultura e sporti
- Shërbimet publike
- Bujqësia
- Transporti
- Banimi
- Afarist

Analiza e potencialit të efijencës së energjisë ne ndriçim publik:

Vërejtje;

Në ndriçim publik do të bëhet analiza e thellë e konsumit të energjisë, potenciali i kursimit të energjisë, shpenzimet në mirëmbajtje, investimet dhe kthimi i investimeve, duke u bazuar në gjendjen ekzistuese dhe kapacitetin instalues ku do të duhet të jepen të dy propozimet për investim dhe kthim të investimit në ndriçim publik. Përmbledhja e këtij aneksi do të vendoset në PVKEK 2023-2030 si shtojcë.

Potenciali i përgjithshëm i kursimit të energjisë;

Për të gjithë sektorët e konsumit të energjisë; Shërbime, Rezident, Afarizëm, Transport dhe Bujqësi

Analiza e reduktimit të emitimit të gazrave;

Për të gjithë sektorët e konsumit të energjisë; Shërbime, Rezident, Afarizëm, Transport dhe Bujqësi.

Konsumi i përgjithshëm i energjisë dhe emetimet aktuale të gazrave ser;

Për të gjithë sektorët e konsumit të energjisë; Shërbime, Rezident, Afarizëm, Transport dhe Bujqësi

Informatat plotësuese për hartimin e PVKEK 2023-2030 duhet të përmbaheni në përpikëri modelit të cilën gjeni të bashkëlidhur si në vazhdim:

Model i Planit Komunal të Veprimt për Energji dhe Klimë (PKVEK) 2022-2030

Kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së ofruesit të shërbimeve:

Kriteret e përgjithshme të kësaj thirrje publike për Hartimin e Planit Komunal të Veprimit për Energji dhe Klime (PKVEK) për Komunën e Gjakovës kanë paraparë një numër të kushteve të përgjithshme të cilat duhet t'i plotësojë aplikuesi.

Përmes vendosjes së këtyre kushteve të përgjithshme aplikohen standardet minimale formale të cilat kërkohen të plotësohen nga aplikuesi i cili do të hartojë PKVEK-ne për Komunën e Gjakovës sipas kritereve të kërkuara.

- Kushtet e përgjithshme që duhet të plotësohen nga ofruesi i shërbimeve (aplikuesi) janë:
 1. Të ketë certifikatën e regjistrimit të OJQ-së;
 2. Vërtetimin e ATK-së kjo dëshmi do të kërkohet vetëm për OJQ e cila propozohet për dhënie të kontratës;
 3. Vërtetimin e Gjykatës vetëm për dhënie të kontratës;
- Ofruesi i shërbimeve duhet të ofrojë një listë të stafit profesional të cilës duhet të ja bashkëngjisë dëshmitë e kërkuara si më poshtë:

Nr.	Kërkesat minimale	Dëshmitë
1	2 (dy) Inxhinier me nivelin master (ose ekuivalente) në Inxhinierin Elektrike ose Mekanike, të certifikuar si Auditor të Energjisë sipas standardit EN 16247, me përvojë pune 5 (pesë) vjeçare: në zhvillimin e politikave të EE në përputhje me legjislacionin në Kosovë, përvojë në hartimin e Planeve për Energji të Qëndrueshme ose Hartimin e Planeve tjera për EE, për nivelin lokal ose kombëtare.	Diplomat universitare, CV-të, referencat që dëshmojnë përvojën e punës specifike sipas kërkesës, certifikatat e auditorëve të energjisë sipas standardit EN 162447
2	3 (tre) Inxhinier me nivelin master (ose ekuivalent) në Inxhinierin Elektrike ose Mekanike ose të Ndërtimit, të certifikuar si Auditor të Energjisë sipas standardit EN 16247, me përvojë pune 3 (tri) vjeçare: në zhvillimin e politikave të EE në përputhje me legjislacionin në Kosovë, përvojë në hartimin e Planeve për Energji të Qëndrueshme ose	Diplomat universitare, CV-të, referencat që dëshmojnë përvojën e punës specifike sipas kërkesës, certifikatat e auditorëve të energjisë sipas standardit EN 162447

	Hartimin e Planeve tjera për EE, për nivelin lokal ose kombëtare.	
3	1 (një) ekonomist të diplomuar të nivelit master (ose ekuivalente), me përvojë pune 3 (tri) vjeçare ne fushën profesionale qe ka te beje me vlerësimin ose analizat e koponentes të politikave te EE.	Diploma universitare, CV-a, referencat që dëshmojnë përvojën e punës specifike sipas kërkesës.

Kohëzgjatja e projektit për hartimin e PKVEK-se për Komunën e Gjakovës.

- Periudha e zbatimit te kontratës është 3 muaj (shënim: Kontrata duhet të përfundojë ne Prill 2023)
- Te drejtë aplikimi kane OJQ-ët që plotësojnë kriteret e lartpërmendura dhe qe dëshmojnë se stafi i tyre është i përgatitura me eksperiencë te lart ne fushën e energjisë, eficences dhe klimës.
- Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve/ofertave, vlerësimit te aplikacioneve/ofertave, kontraktimi, koha dhe mënyra e parashtrimit te ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit te thirrjes janë konform ligjit.

Vlerësimi i ofertave/aplikacioneve nga komisioni

- Komisioni Vlerësues i ofertueseve për hartimin e Planit Komunat të Veprimit për Energji dhe Klime (PKVEK) për Komunën e Gjakovës varësisht nga kushtet dhe kërkesat e thirrjes lidhur me përmbushjen e kriterëve formale do te bëjë vlerësimin formal te dokumentacionit te dorëzuar nga aplikuesit.
- Përmbushja e kriterëve formale nënkupton dorëzimin brenda afatit te dokumentacionit, te kërkuara përmes thirrjes. Komisioni do te vlerësoj edhe në rast të vetëm një ofertë të përgjegjshme.
Komisioni do te jetë ne përbërje: 3 anëtar nga Komuna e Gjakovës.

Financimi i aktiviteteve për hartimin e PKVEK-se për Komunën e Gjakovës

Komuna e Gjakovës bën thirrje për OJQ e interesuara (ofrues të shërbimeve), fushëveprimi i të cilëve është i fokusuar në fushën e energjisë dhe klimës që të aplikojnë për ofrimin e shërbimeve lidhur me hartimin e Planit Komunal të Veprimit për Energji dhe Klime (PKVEK) për Komunën e Gjakovës.

- Vlera totale e planifikuar e thirrjes është: **85,500.00 EURO**
- Dokumentet e kërkuara për këtë aplikim duhet të dorëzohen në mënyrë fizike të mbyllura në zarf (3 zarfe), njëri zarf duhet të shënoj origjinali ndërsa dy tjerët duhet të shkruhet kopje, zarfet duhet të jenë të vulosura nga ofertuesi me mbi shkrimin ofertë për hartimin e PKVEK.
- Zarfet dorëzohen në sekretarinë e DSHP-ës, kati II nr. 21, ndërtesa e ish-bankosit, Komuna e Gjakovës, Gjakovë 50000.
- Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është 10 dite kalendarike nga data e publikimit (nga data **13.01.2022**) dhe përfundon me **23.01.2023** në ora **15:30**.